

RAPORT PARAPRAK Nr.1¹

27 mars – 11 prill 2011

15 prill

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- Më 6 shtator 2010, Presidenti i Shqipërisë deklaroi se zgjedhjet do të mbahen më 8 maj 2011 për kryetarët e bashkive, kryetarët e komunave, dhe këshillat e 384 njësive të qeverisjes vendore.
- Këto janë zgjedhjet e para vendore që do të mbahen që nga ndryshimet e kushtetutës të bëra në 2008, e ndjekur kjo nga adoptimi i Kodit të ri Zgjedhor. Kodi Zgjedhor ka një sërë hapësirash boshe dhe përmban paqartësi në lidhje me zgjedhjet lokale.
- Tre kandidatët e emëruar nga opozita pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) e ndërprejnë pjesëmarrjen në mbledhjet e KQZ-së në janar 2011, por u rikthyen më 8 prill.
- Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-të) nuk u ngritën brenda afatit të përcaktuar kohor, për shkak se të gjitha partitë e regjistruara nuk arritën të dorëzonin të emëruarit e tyre. Partitë e mazhorancës emëruan anëtarët e komisioneve menjëherë pas këtij momenti, por partitë opozitare nuk e bënë një gjë të tillë deri në fund të marsit. Përkohësisht, KQZ-ja caktoi kandidatët nga organizatat e shoqërisë civile në KZAZ-të.
- Janë bërë përpjekje për të eliminuar dublimet në regjistrime dhe të dhënat për personat e vdekur, duke bërë verifikimin e saktësisë së të dhënave. Lista Paraprake e Votuesve (LPV) u afishua për t'u verifikuar nga publiku në tetor 2010, dhe partive politike u është dërguar kopja elektronike e LPV-së.
- Gjithsej 49 parti regjistruan kandidatët me 22 konkurrentë për zgjedhjet si pjesë e koalicionit të kryesuar nga Partia Demokratike (PD-ja), Aleanca për Qytetarin dhe 23 konkurrentë si pjesë e koalicionit të drejtuar nga Partia Socialiste (PS-ja), Aleanca për të Ardhmen.
- Ndërsa periudha zyrtare 30-ditore e fushatës filloi më 8 prill, partitë e kishin filluar fushatën në mënyrë aktive para asaj date. Sulmet e ashpra personale vazhduan të karakterizojnë fushatën. Të dyja, si PD-ja dhe PS-ja janë fokusuar në garën për Kryetar Bashkie në Tiranë.
- Më 28 mars, KQZ-ja ngriti Bordin për Monitorimin e Mediave, që ka për detyrë të monitorojë përmbushjen e dispozitave të Kodit Zgjedhor për median. Vetëm katër nga shtatë anëtarët e tij u caktuan fillimisht, për shkak të mungesës së anëtarëve të KQZ-së të emëruar nga opozita.
- KQZ-ja ka marrë deri tani 55 ankesa kundër vendimeve të KZAZ-ve, që kanë të bëjnë kryesisht me moslejimin e regjistrimit të kandidaturave.
- Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ) i OSBE/ODIHR-it filloi aktivitetin e tij në Tiranë më 28 mars, me një ekip bërthamë prej 15 anëtarësh. Më 5 prill, 24 vëshgues afatgjatë u shpërndanë në gjithë vendin. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it filloi monitorimin e pesë stacioneve televizive dhe katër gazetave më 4 prill.

¹ Versioni anglisht është i vetmi dokument zyrtar. Megjithatë, ky raport është i disponueshëm edhe në gjuhën shqipe.

II. HYRJE

Presidenti i Shqipërisë, Z. Bamir Topi, deklaroi më 6 shtator 2010 se zgjedhjet për qeverisjen vendore do të mbahen më 8 maj 2011. Pas ftesës së bërë nga Misioni i Përhershëm i Republikës së Shqipërisë, më 5 nëntor 2010, Zyra e OSBE për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) dërgoi një Mision për Vlerësimin e Nevojave (MVN) në Shqipëri, në periudhën 17-21 janar 2011.²

Bazuar në rekomandimet e MNV-së së OSBE/ODIHR, një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) u krijua më 28 mars.³ MVZ-ja e OSBE/ODIHR kryesohet nga Z. Jonathan Stonestreet dhe përbëhet nga një ekip bërthamë prej 15 anëtarësh me bazë në Tiranë dhe 24 vëzhgues afatgjatë të shpërndarë në terren në 11 zona të ndryshme në të gjithë vendin. OSBE/ODIHR u ka kërkuar Shteteve pjesëmarrëse të dërgojnë 400 vëzhgues afatshkurtër që të vëzhgojnë procesin e votimit, numërimin dhe përgatitjen e tabelave përmbledhëse me rezultatet. OSBE/ODIHR ka vëzhguar nëntë procese zgjedhore në Shqipëri që nga viti 1997.⁴

III. SFONDI HISTORIK DHE KONTEKSTI POLITIK

Zgjedhjet e 8 majit 2011 janë zgjedhjet e para vendore që do të zhvillohen që nga momenti i ndryshimeve në Kushtetutë dhe adoptimi i Kodit të ri Zgjedhor më 2008. Në 2009-ën, koalicioni zgjedhor i kryesuar nga PD-ja fitoi 70 nga 140 vende në parlament (Kuvend) dhe formoi një qeveri me Lëvizjen Socialiste për Integrim (LSI), e cila fitoi katër vende. Rezultatet e zgjedhjeve u kundërshtuan nga koalicioni zgjedhor që kryesohej nga PS-ja, dhe deputetët e saj bojkotuan parlamentin deri në mars 2010.

Që nga zgjedhjet e 2009-ës, mjedisi politik ka vazhduar të jetë shumë i polarizuar, me një retorikë të ashpër dhe sulme personale, si edhe demonstrata nga ana e opozitës. Tensioni u rrit menjëherë pas një proteste anti-qeveritare të organizuar nga PS-ja në Tiranë, më 21 janar 2011, ku pati përleshje të ashpra ndërmjet protestuesve dhe forcave të sigurisë. Katër persona u vranë dhe shumë të tjerë u plagosën. Parlamenti nisi një hetim, ndërsa Prokurorja e Përgjithshme nisi një hetim të veçantë për gjuajtjet me armë. Këto hetime, që ndezën edhe më shumë kundërshtitë politike, nuk kanë përfunduar ende.

Pas ngjarjeve të 21 janarit, ka patur disa vizita ndërkombëtare të nivelit të lartë për t'u bërë thirrje për qetësi dhe përgjegjësi në përgatitjet për zgjedhjet e 8 majit. Presidenti u ka bërë thirrje të gjitha partive të sillen në mënyrë të përgjegjshme dhe të veprojnë në përputhje me ligjin. Të dyja palët, si udhëheqësit e mazhorancës, ashtu edhe ata të opozitës kanë deklaruar se ata kanë si prioritet që zgjedhjet të zhvillohen në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe detyrime të tjera në nivel ndërkombëtar. PS-ja ka shprehur shqetësimin duke thënë se nuk beson se do të ndodh kështu dhe ka bërë një numër propozimesh për “të garantuar” procesin, përfshi përdorimin e skanerave për Kartat e Identitetit, aksesin ndaj përditësimit të listës paraprake të votuesve, ri-numërimin e votave me kërkesën e dy anëtarëve të KQZ-së, dhe kontrollin pas-zgjedhor të materialeve zgjedhore. PD-ja ka shprehur besim të plotë për procesin e zgjedhjeve.

Një nga rekomandimet kryesore të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të 2009-ës kishte të bënte me përgjegjësinë e partive për të bërë përmbushjen e detyrave zgjedhore në një mënyrë të përgjegjshme. Me mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar, një tryezë e rumbullakët diskutimi u organizua me partitë parlamentare në fund të marsit për një “marrëveshje të vullnetit të mirë” bazuar në këtë rekomandim. Partitë e mazhorancës e firmosën marrëveshjen, ndërsa partitë e opozitës nuk e

² Raporti i MNV-së së OSBE/ODIHR-it gjendet ne: www.osce.org/odihr/75455.

³ Faqja e internetit e MVZ-së është www.osce.org/odihr/elections/76217.

⁴ Raportet e misioneve të mëparshme të vëzhgimit të OSBE/ODIHR në Shqipëri gjenden në:

nënshkruan atë duke përdorur si argument faktin që propozimet e tyre nuk u pranuan. Partitë e mazhorancës e firmosën marrëveshjen.

IV. KUADRI LIGJOR

Kuadri ligjor që rregullon zgjedhjet e 2011-ës për qeverisjen vendore përbëhet së pari nga Kushtetuta (e ndryshuar më 21 prill 2008) dhe Kodi Zgjedhor (adoptuar në 28 dhjetor 2008). Dispozitat e Kodit Zgjedhor mbështeten dhe zbatohen nga vendimet dhe udhëzimet e KQZ-së. Tjetër legjislacion që zbatohet përfshin Ligjin mbi Demonstratat, Ligjin për Qeverisjen Vendore, dhe dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile, të Kodit të Procedurës Administrative dhe të Kodit Penal. Ligji për Partitë Politike u amendua thellë në shkurt 2011, sidomos në lidhje me financimin e partive politike.

Kuadri ligjor është vlerësuar paraprakisht dhe është konstatuar së siguron themelin për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, nëse zbatohet me përpikmëri dhe me synimin që të respektohet përmbajta dhe fryma e ligjit.⁵ Kodi i ri Zgjedhor në 2008-ën adresoi një numër rekomandimesh të bëra më parë nga OSBE/ODIHR; sidoqoftë, disa prej rekomandimeve mbeten akoma të paadresuara, përfshi ato të Raportit Final të OSBE/ODIHR-it mbi zgjedhjet parlamentare të 2009-ës. Qeveria e informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it për synimin që kishte për t'i ndjekur rekomandimet pas përfundimit të zgjedhjeve vendore.

Kodi Zgjedhor ka një numër boshllëqesh dhe paqartësish në lidhje me zgjedhjet për qeverisjen vendore. Për shembull, ai nuk shprehet qartë nëse ka një prag minimal në lidhje me përfaqësimin në këshillat vendore, dispozitat për financimin e fushatës me fonde publike nuk gjejnë zbatim të plotë për zgjedhjet vendore, dhe nuk ka dispozitë lidhur me regjistrimin e kandidatëve për bashkinë e Tiranës, pasi ligji nuk specifikon një organ kompetent për administrimin e zgjedhjeve.

V. SISTEMI ZGJEDHOR

Kryetarët e Bashkive, kryetarët e komunave dhe këshillave të 384 njësive të qeverisjes vendore zgjidhen përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta. Zona zgjedhore për zgjedhjet vendore është territori i bashkisë apo komunës dhe, në Tiranë, të 11 njësitë bashkiake në të cilat është i ndarë qyteti. Këshilltarët zgjidhen sipas sistemit proporcional, ndërkohë që kryetarët e bashkisë dhe të komunave zgjidhen sipas sistemit mazhoritar. Numëri i këshilltarëve që zgjidhen në çdo NjQV përcaktohet sipas popullsisë që ka, duke shkuar nga 13 anëtarë në komunat më të vogla deri në 45 anëtarë në qytetet me popullsi deri në 200,000 banorë. Këshilli i Tiranës do të ketë 55 vende.

Kodi Zgjedhor përcakton një prag tre dhe pesë përqind për partitë e koalicionit që respektivisht kanë të drejtën e ligjshme të marrin pjesë në ndarjen e mandateve në një zonë zgjedhore për zgjedhjet parlamentare, por është e paqartë nëse i njëjti prag do të zbatohet edhe për zgjedhjet vendore. Në mungesë të një dispozite të qartë, Kryetari i KQZ-së informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se KQZ-ja do të përdorë po ato pragje që u përdorën për zgjedhjet parlamentare.

VI. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet vendore administrohen nga një organizëm me tre nivele për administrimin e zgjedhjeve, që përbëhet nga një KQZ, 66 KZAZ dhe 4,932 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV).

KQZ-ja është një organ prej shtatë anëtarësh i zgjedhur nga Kuvendi Popullor. Kryetari emërohet nga partia më e madhe e mazhorancës; tre anëtarë emërohen nga partitë e mazhorancës dhe tre

⁵ Shikoni Raportin Përfundimtar të OSBE/ODIHR mbi zgjedhjet parlamentare të 2009 në Republikën e Shqipërisë, që gjendet në: www.osce.org/odihr/elections/albania/38598. Gjithashtu, Mendimin e Përbashkët të OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venecias pranë Këshillit Europian mbi Kodin Zgjedhor, që gjendet në:

anëtarë (përfshi edhe Nënkyetarin) nga partitë e opozitës. Sipas të njëjtit model, KZAZ-të dhe KQV-të përbëhen nga shtatë anëtarë të zgjedhur dhe të emëruar nga një nivel më i lartë i administratës zgjedhore mbi bazën e propozimeve të partisë. Postet e kryetarëve të KZAZ-ve dhe KQV-ve ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet partisë më të madhe të mazhorancës dhe partisë më të madhe të opozitës.

Tre anëtarët e emëruar nga opozita e ndërprejnë pjesëmarrjen në mbledhjet e KQZ-së në janar, për shkak të mosmarrëveshjeve me anëtarët e mazhorancës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme të KQZ-së. Për shkak të kërkesës ligjore për marrjen e disa vendimeve me shumicë të cilësuar (të paktën pesë anëtarë të KQZ-së), KQZ-ja nuk ka qenë në gjendje të adoptojë udhëzimet për zhvillimin e zgjedhjeve, përfshi edhe lidhur me fondet shtetërore për subjektet zgjedhore dhe rregulloret për fushatat. Derisa të aprovohen udhëzimet e reja, udhëzimet e dhëna në 2009-ën mbeten në fuqi. Më 8 prill, tre anëtarët e emëruar nga opozita filluan të ndjekin mbledhjet e KQZ-së, edhe pse çështja e rregullave për procedurën nuk është zgjidhur ende.

KZAZ-të duhet të ishin ngritur që më 7 shkurt, por asnjë nga partitë e regjistruara nuk dorëzoi të emëruarit e tyre brenda afatit të caktuar. Edhe pse partitë e mazhorancës kanë emëruar anëtarët e komisionit menjëherë pas kësaj, partitë e opozitës nuk e bënë këtë gjë, duke e lënë gjysmën e KZAZ-ve pa kuorum. Kodi Zgjedhor nuk përcakton masa korrigjuese në këtë rast. KQZ-ja emëroi një anëtar shtesë nga organizatat e shoqërisë civile në 33 KZAZ-të që kishin vetëm tre anëtarë, me qëllim që të krijohej kuorumi.

Në këtë mënyrë, edhe pse Kodi Zgjedhor nuk e parashikon emërimin e anëtarëve të KZAZ-ve, kryetari i KQZ-së deklaroi se kjo masë ishte e nevojshme për të garantuar se hapat kyçe të procesit të zgjedhjeve, si regjistrimi i kandidatëve nga KZAZ-të, të mund të bëheshin. Në fund të marsit, partitë e opozitës dorëzuan propozimet e tyre për anëtarët e KZAZ-ve. KQZ-ja i emëroi ata, duke pranuar dorëheqjen e anëtarëve të përkohshëm nga organizatat e shoqërisë civile. Deri tani, KQZ-ja ka zëvendësuar 60 anëtarë të KZAZ-ve sipas emerimeve të kerkuara nga partitë.⁶

Numërimi do të bëhet në 66 Qendra të Numërimit të Votave (QNV), një për çdo Zonë të Administrimit Zgjedhor. Të gjitha partitë kanë kërkuar që MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it të ofrojë një mbulim maksimal të procedurave të numërimit, që pritet të zgjasin përtej afatit kohor ligjor që është ora 17:00 e të nesërme së ditës së zgjedhjeve. KQZ-ja nuk përcaktoi vendndodhjen e QNV-ve brenda afatit të caktuar kohor që ishte 8 prilli.

VII. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Shqipëri ka një sistem pasiv për regjistrimin e votuesve me lista votuesish të nxjerra nga baza elektronike e të dhënave e Regjistratit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC-së), që mbahet nga Ministria e Brendshme. Baza e të dhënave e RKGjC-së bazohet në informacionin që merret nga Zyrat e Gjendjes Civile, që janë pjesë e administratës vendore. Ministrisë së Brendshme ka bërë përpjekje për eliminimin e regjistrimeve të dubluara dhe të dhënave për personat e vdekur duke verifikuar saktësinë e të dhënave që ka. Në tetor dhe nëntor 2010, u gjetën 39,000 dokumenta me mundësi dublimi në Regjistrin Civil, që u korrespondojnë rreth 19,000 qytetarëve. Pasi u bënë verifikimet nga Zyrat e Gjendjes Civile, numri i dokumentave me dublime të mundshme ra në 1,600.

LPV-ja u afishua për t'u kontrolluar nga publiku në tetor 2010, dhe partitë politike morën kopje elektronike të LPV-së. Menjëherë pas kësaj, SP-ja shprehu shqetësimin se votuesit po shtoheshin në mënyrë të paligjshme në regjistrat e gjendjes civile në disa prej NjQV-ve, përfshi njësitë bashkiake që kontrollohen nga PD-ja dhe LSI-ja në Tiranë, me qëllim që të ndryshojnë ekuilibrin politik të pushtetit në këto zona. PS-ja kërkoi që përditësimet e rregullta të LPV-së, për reflektimin e

⁶ Neni 32.d shprehet se anëtarët e KZAZ-së nuk mund të shkarkohet nga detyra prej KQZ-së kur, subjekti

ndryshimeve të vazhdueshme në statusin e regjistrimit të votuesve, t'u vihen atyre në dispozicion. Kjo u kundërshtua nga Ministria e Brendshme, që tha se Kodi Zgjedhor u siguron partive vetëm të marrin LPV-të dhe Listat Përfundimtare të Votuesve (LPV-të).

Ministria e Brendshme dha informacion publik më 9 prill se Lista Përfundimtare e Votuesve për zgjedhjet vendore të 2011-ës përmban 3,164,859 votues, rreth 23,200 më pak se Listat Paraprake të Votuesve (LPV-të). Votuesit mund të kontrollojnë të dhënat e tyre individuale në faqen e internetit të Ministrisë së Brendshme dhe KQZ-së, dhe partitë kanë të drejtën të marrin një kopje të gjithë listës së votuesve.

VIII. REGJISTRIMI I PARTIVE DHE KANDIDATËVE

Zgjedhjet për qeverisjen vendore mund të kontestohen nga kandidatët e emëruar nga partitë politike, koalicionet e partive politike, apo kandidatët e pavarur të emëruar nga grupe votuesish (subjektet e zgjedhura). Partitë politike dhe komitetet nismëtare të grupeve të votuesve mund të propozojnë kandidatë për zgjedhjet vendore nëse ata regjistrohen pranë KQZ-së të paktën 60 ditë para ditës së zgjedhjeve.⁷ Dy apo më shumë parti mund të formojnë një koalicion nëse regjistrohen si të tilla jo më vonë se 45 ditë para ditës së zgjedhjeve.

Një total prej 56 partish politike u regjistruan për këto zgjedhje. Prej tyre, 49 kanë regjistruar kandidatë, ku 22 konkurrojnë në zgjedhje si pjesë e koalicionit të kryesuar nga PD-ja, i quajtur Aleanca për Qytetarin dhe 23 parti që konkurrojnë si pjesë e koalicionit të kryesuar nga PS-ja, i quajtur Aleanca për të Ardhmen. KQZ-ja refuzoi regjistrimin e dy partive për arsye të dokumentacionit të paplotë për regjistrimin.

Partive dhe grupeve të votuesve iu kërkua të dorëzonin emrat e të gjithë kandidatëve për kryetar bashkie dhe listat e kandidatëve për këshillat vendor pranë KZAZ-ve jo më vonë se 40 ditë para ditës së zgjedhjeve.⁸ Në rastet kur subjekteve zgjedhore iu kërkua të korrigjonin gabimet në dokumentat e tyre, dita e fundit që KZAZ-të të vendosnin për këto lista ishte 7 prilli. Një numër i kandidatëve të pavarur të refuzuar që u ankuan kundër vendimeve të KZAZ-ve tek KQZ-ja praktikisht arritën të regjistrohen; apelimet vazhdojnë akoma. Të dhënat përfundimtare për regjistrimin e kandidatëve në nivel KZAZ-je nuk disponoheshin në nivel KQZ-je në momentin kur u shkrua ky raport.

IX. FUSHATA E ZGJEDHJEVE

Ndërsa periudha zyrtare 30-ditore për fushatën filloi më 8 prill, partitë kishin filluar me kohë të promovonin veten në mënyrë aktive para asaj date. Drejtuesit e partive organizuan mitingje me votuesit dhe prezantuan kandidatët vendor. Një reklamë televizive e OJF-së *Zgjohu*, para periudhës zyrtare të fushatës, sulmoi punën e liderit të PS-së, që është kandidati në detyrë si kryetar i bashkisë së Tiranës. PS-ja ka kërkuar një hetim me pretendimin se spoti u financua me fonde publike.

Që nga 8 prilli, intensiteti i aktiviteteve të fushatës është rritur. Temat e fushatës përfshijnë zhvillimet në infrastrukture, cilësi të shërbimeve që ofron bashkia dhe zgjidhje të papunësisë. Sulmet e ashpra personale kanë vazhduar të karakterizojnë fushatën, me akuza për korrupsion nga të dy anët. Të dyja palët si PD-ja, edhe PS-ja i kanë kushtuar vëmendje të madhe garës për kryetar bashkie në Tiranë.

Dy kandidatë u qëlluan dhe u plagosën më 1 prill në Tiranë dhe 2 prill në Lezhë. Sipas policisë, plagosja në Tiranë u bë për motive politike, ndërsa rasti në Lezhë nuk kishte lidhje me politikën. Më

⁷ Partitë pa përfaqësim në Kuvend apo në këshillin vendor përkatës duhet të japin një listë me firma që përbëjnë të paktën një përqind të votuesve të regjistruar në zonën zgjedhore që të nominojnë kandidatët. Një grup votuesish duhet të sigurojnë një numër të njëjtë firmash, përjashtojnë rastet kur kandidati i tyre tashmë është kryetar bashkie.

⁸ Neni 67 i Kodit Zgjedhor. Sipas KQZ-së, kjo nënkuptonte jo më vonë se 28 marsi, interpretim që u kontestua

4 prill, Kryetari i Zyrës së Inspektoriatit Ndërtimor në Bashkinë e Tiranës u qëllua dhe u plagos. Një ditë më parë ai kishte urdhëruar heqjen e flamujve politik të vendosur në vende të paautorizuara. Hetimi nga ana e policisë vazhdon ende. Vendosija e materialeve të fushatës, si flamuj dhe banderola, ka çuar gjithashtu në grindje në disa raste.

X. MEDIA

Kodi Zgjedhor përmban dispozita të detajuara lidhur me mbulimin nga media të partive politike gjatë periudhës zyrtare të fushatës. Kodi përcakton detyrimet për kohë të lirë transmetimi, mbulim me lajme dhe reklama të paguara, përcakton një periudhe heshtjeje në fushatë, ndalon publikimin e sondazheve të opinionit publik pesë ditë nga dita e zgjedhjeve, dhe i kërkon transmetuesit publik t'i japë KQZ-së 90 minuta kohë transmetimi për informacione sqaruese për zgjedhësit.

Në përputhje me Kodin Zgjedhor, KQZ-ja udhëzoi transmetuesin publik, Radio-Televizionin Shqiptar (RTSH) t'i japë 60 minuta kohë transmetim në dispozicion të partive të mëdha politike (PD dhe PS), 30 minuta për partitë e vogla parlamentare dhe 10 minuta për secilën nga 43 partitë jo-parlamentare që u regjistruan para fillimit të fushatës zgjedhore.⁹ Më 7 prill, transmetuesi publik hodhi shortin për të përcaktuar radhën e shfaqjes së partive politike. Që nga 8 prilli, RTSH-ja ka transmetuar hapësirat kohore falas gjatë orarit të mbrëmjes që ka shikueshmërinë më të madhe.

Sipas dispozitave ligjore, mbulimi i të dy partive të mëdha politike në minutazhin e lajmeve që transmetohet nga çdo media duhet të jetë i barabartë, dhe duhet të jetë dyfishi i minutazhit për partitë e vogla. Mbulimi gjatë lajmeve i partive jo-parlamentare përcaktohet nga redaktorët, por nuk duhet të kalojë kohën e transmetimit që u kushtohet partive të vogla parlamentare. Reklama politike me pagesë lejohet, por është e kufizuar në median vizive.¹⁰ PD-ja dhe SP-ja kanë filluar të japin reklamën e tyre të paguara në TV pas fillimit të periudhës kohore zyrtare për fushatën.

Më 28 mars, KQZ-ja ngriti Bordi i Monitorimit të Medias, organizmi që ka përgjegjësinë të monitorojë zbatimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor për median. Vetëm katër nga anëtarët e tij (të caktuar nga anëtarët e emëruar në KQZ nga mazhoranca) janë emëruar në kohën kur u shkrua ky raport. Më 8 prill, Bordi i Monitorimit të Medias filloi të monitorojë 62 kanale televizive dhe 2 stacione radiofonike; atij i duhet të dorëzojë raporte me shkrim pranë KQZ-së.

Më 4 prill, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it filloi monitorimin për një grup të përzgjedhur mediash, përmes një analize lidhur me standartet sasiore dhe cilësore të mbulimit të zgjedhjeve që ato bëjnë.¹¹

XI. ANKESAT DHE APELIMET

Kodi Zgjedhor u njehtë drejtën për depozitim ankese apo apelimi tre grupeve: subjekteve zgjedhore, individëve apo partive politike që u është mohuar regjistrimi si subjekte politike dhe atyre që u është mohuar akreditimi si vëzhgues të zgjedhjeve. Ankesat mbi ecurinë e procesit zgjedhor, për vendimet e KZAZ-ve dhe mosmarrja e një vendimi nga KZAZ-të, dorëzohen pranë KQZ-së. Vendimet e KQZ-së dhe mosmarrja e një vendimi, mund të apelohej pranë Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit për Tiranën, vendimet e të cilit janë të formës së prerë.

Deri tani KQZ-ja ka marrë 55 ankesa kundër vendimeve të KZAZ-ve, që kanë të bëjnë kryesisht me mohimin e regjistrimit për kandidaturat. Një e katërta e ankesave të paraqitura u rrëzuan për arsye procedurale, pasi u depozituan pas afatit kohor ligjor. Në dy rastet e tjera, KQZ-ja përdori standarte

⁹ Partitë e mëdha politike janë ato me të paktën 20% të vendeve në parlament. Partitë e vogla janë ato me më pak se 20% të vendeve në parlament.

¹⁰ Mostra e përzgjedhur përfshin pesë kanale TV (RTSH, Top Channel, TV Klan, Vizion Plus dhe News 24), çdo ditë nga ora 18:00 deri në 24:00, dhe katër gazeta të përditshme (Shqip, Gazeta Shqiptare, Panorama dhe 55).

të ndryshme për partitë parlamentare nga ato jo-parlamentare. Në të dy rastet, partitë pretenduan se ato nuk e kapën afatin e caktuar kohor për regjistrimin e kandidatit, për shkak se anëtarët e KZAZ-ve nuk ndodheshin në zyra. KQZ-ja i vlerësoi të dy pretendimet si të paprovuara, duke rrëzuar rastin e partisë jo-parlamentare, por duke e udhëzuar KZAZ-në të pranonte dokumentat në rastin e dytë, ku apeluesi ishte PS-ja. Në rastin e fundit, KQZ-ja vendosi se, edhe pse ishte shkelur afati përfundimtar, e drejta e votuesve për të zgjedhur duhej mbrojtur.

Dy apelime janw shqyrtuar nga Kolegji Zgjedhor, të dyja kishin të bënin me mohimin e regjistrimit për komitetet nismëtare të grupeve të votuesve. Kolegji Zgjedhor e rrëzoi apelimin e parë dhe pranoi të dytin. Edhe pse Kodi Zgjedhor kërkon që Kolegji Zgjedhor duhet t'i zbardhë vendimet brenda tre ditësh, ky afat kohor nuk u respektua në asnjërin prej rasteve. Për këtë arsye, arsyetimi i Kolegjit Zgjedhor nuk ishte i disponueshëm në kohën kur u shkruajt ky raport.

PS-ja depozitoi dy ankime pranë Kolegjit Zgjedhor në lidhje me përmbajtjen e fletëve të votimit për zgjedhjet për kryetar bashkie dhe këshill në Tiranë. Për garën për kryebashkiakun, PS-ja kërkoi që akronimet e të gjitha partive që bëjnë pjesë në koalicion të vihen në fletën e votimit nën emrin e koalicionit, njëlloj si për koalicionin e kryesuar nga PD-ja. Për garën për kryetar këshilli, PS-ja kërkoi të ndryshohet radhitja e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit.¹²

PD-ja apeloj pranë Këshillit Zgjedhor edhe vendimin e KQZ-së lidhur me fletën e votimit për zgjedhjet për Këshillin e Tiranës, duke kërkuar që të gjitha partitë e koalicionit të vet, përfshi edhe ato që nuk kanë regjistruar kandidatë, të vihen në fletën e votimit.

XII. PJESËMARRJA E GRAVE

Roli i grave në jetën publike shqiptare mbetet i kufizuar. Njëzet e tre nga 140 deputetë në Kuvend janë gra (16.4 përqind). Kodi Zgjedhor përmban dispozita që garantojnë pjesëmarrjen si të grave, edhe të burrave në KQZ dhe në KZAZ-të. Për QNV-të, nuk ka kërkesë lidhur me çështjen gjinore. Dy nga shtatë anëtarë të KQZ-së janë gra. Kodi kërkon që secila gjini të përbëjë të paktën 30 përqind të anëtarëve të emëruar në KZAZ nga partia më e madhe mazhoritare dhe partia më e madhe e opozitës. Kodi Zgjedhor përcakton gjithashtu se në zgjedhjet vendore një në tre emra në secilën listë të kandidatëve për këshillat vendore duhet t'i përkasë gjinisë femërore. Sidoqoftë, dështimi në respektimin e kuotave nuk e pengon regjistrimin e listës por rezulton në një gjobë prej vetëm 30,000 Lek (afërsisht 215 Euro).¹³

XIII. VËZHguesIT VENDAS

Vëzhguesit zgjedhor jopartiak vendas janë akredituar nga KQZ-ja dhe vëzhguesit partiak nga KZAZ-të. KQZ-ja ka akredituar 145 vëzhgues të Koalicionit të Vëzhguesve Vendas të përbërë nga tre organizata (Shoqëria për Kulturë Demokratike, KRIIK Albania dhe Qendra e Grave dhe Fëmijëve në Kombinat) dhe 125 vëzhgues nga Unioni për Cilësinë e Jetës në Shqipëri.

Partitë politike që emërojnë kandidatë në një zonë zgjedhore mund të caktojnë vëzhgues për KZAZ-të respektive, KQV-të dhe tavolinat e numërimit në QNV-të. Për partitë në koalicion, vëzhguesit mund të caktohen vetëm nga koalicioni.

XIV. AKTIVITETET E MVZ-së së OSBE/ODIHR-it

¹² Subjektet zgjedhore janë renditur në fletën e votimit sipas rendit alfabetik. Koalicioni i kryesuar nga PS-ja është *Aleanca për të Ardhmen*, ndërsa koalicioni i kryesuar nga PD-ja është *Aleanca për Qytetarin*. PS pretendon se njaja "të" nuk duhet marrë në konsideratë.

MVZ-ja e OSBE/ODHIR-it i filloi aktivitetet e veta në Tiranë më 28 mars, me një ekip bërthamë prej 15 anëtarësh. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it është takuar me Kryeministrin, Ministrin e Punëve të Jashtme, KQZ-në, Kryetarin e Bashkisë së Tiranës, dhe përfaqësues të një spektri të gjerë të partive politike, kandidatëve, mediave, vëzhguesve vendas dhe komunitetin ndërkombëtar. Dymbëshjetë ekipe vëzhguesish afatgjatë u caktuan në njëmbëdhjetë pika në gjithë vendin më 5 prill. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it është mirëpritur nga të gjitha partitë dhe grupet e interesit.